



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **30.05.2025** të parashtruar nga Operatori Ekonomik ANUAR SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik“, Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik “ANUAR” sh.p.k., e dt.30.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik“, Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 03.04.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 03.04.2025;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "ANUAR" sh.p.k. me dt.30.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.06.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pa bazuar, sepse këto kërkesa dhe kërkesat tjera të tenderit këto janë kriteret minimale të cilat duhen të plotësohen, që do të thotë se Inxhinieri i nivelit Master është mbi minimumin e kërkuar në tender. Pra pranohet niveli i Inxhinierit Master me certifikimet përkatëse siq është kërkuar tek kërkesa 8.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Faton Gutaj

për: *Khofu...*
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

